

*Fjalori im*

**KUJDES!**



**ZONA NË KARANTINË**

**KARANTÍN/Ë, -A; emër i gjinisë femërore; shumës; -A(T)**

Masë mbrojtëse për të ndaluar përhapjen e një epidemie, duke mbajtur të veçuar përkohësisht të sëmurët ose ata që dyshohen si të tillë; vendi i veçuar ku mbahen këta të sëmurë ose ku bëhet kontrolli i tyre: karantinë veterinare; vë (heq) karantinën.

Të dashur fëmijë, për shkak të rrethanave ku për shkak të virusit Kovid-19 të gjithë duhet të rrimë në shtëpi, Portalb.mk vendosi të fillojë me Ligën e enigmatikës. Çdo javë do të botojmë një enigmë për ju që jeni nxënës të shkollës fillore (enigmat e botuar ditët tjera nuk janë për fëmijë dhe nuk marrin pjesë në lojën shpërblyese). Ajo që ju duhet të bëni për të marrë pjesë në garë është:

1. E shkarkoni dhe e shtypni në letër enigmën e ditës së shtunë
2. E zgjidhni
3. Faqen e plotësuar me zgjidhjet e skanoni ose e fotografoni me telefon celular ashtu që të duken qartë zgjidhjet
4. I plotësoni të dhënat\* për të vërtetuar se jeni nxënës(e) i/e shkollës fillore:
  - a. Emri dhe mbiemri
  - b. Emri i shkollës fillore
  - c. Datëlindja
  - d. Nënshkrimi dhe emri i njërit prind me çfarë do të konfirmoni se ata janë në dijeni për pjesëmarrjen tuaj në Ligën e Portalb të enigmatikës.
  - e. Numri i telefonit
5. Në afat sa më të shkurtër (sa më shpejtë aq më mirë) i dërgoni zgjidhjet në adresën e-mail: [enigmatika@portalb.mk](mailto:enigmatika@portalb.mk).

Vetëm zgjidhjet e arritura në këtë adresë do të merren parasysh.

**Rregullat:**

- Enigma duhet të jetë e saktë.
- Të gjithat të dhënat e kërkuara duhet të plotësohen
- Zgjidhja e saktë e cila arrin e para në e-mailin tonë [enigmatika@portalb.mk](mailto:enigmatika@portalb.mk) do të marrë **3 pikë**. E dyta merr **2 pikë** dhe e treta vetëm **1 pikë**. Të tjerët nuk do të marrin asnjë pikë.
- Çdo javë do të publikohen rezultatet në Portalb.mk si dhe radhitja në tabelë.
- Liga e enigmatikës do të zgjasë deri më 14 qershor, 2020.

Pasi të përfundojë gara, do të shpallen rezultatet përfundimtare dhe tre vendet e para do të marrin shpërblime dhe do të bëhet një shkrim dhe enigmë enkas për fituesit, i cili do të botohet dhe promovohet në Portalb.mk.

\*Të dhënat tuaja do të ruhen në përputhje me politikën për privatësi të Portalb të cilën po që se dëshironi mund ta lexoni [këtu](#).



1

*Cili numër jam*



Jam > 7+2

Jam < 15-2

Nuk jam numër çift!

2

*Thënia e përzier*

Ë SH PA IT	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	1	19	3	21	12	20	
A P	<input type="text"/>	<input type="text"/>					
	7	8					
J Ë Ë F IM	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>
	9	10	11	5	24	14	
I S	<input type="text"/>	<input type="text"/>					
	15	16					
A N T A	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>			
	17	6	2	22			
P A	<input type="text"/>	<input type="text"/>					
	4	18					
E Y J	<input type="text"/>	<input type="text"/>	<input type="text"/>				
	25	23	13				

Formoni fjalë me shkronjat e përziera. Pastaj, duke i përcjellur numrat, bartni ato në tabelën e poshtme dhe do të fitoni një thënie!

3

*Mini Sudoku me shkronja*

	L	J	
O			
			J
	O	L	

- Plotësojeni katrorin e dhënë me shkronjat: L, O, J, A.
- Shkronjat nuk përsëriten as në rreshta as në kolona e as në katrorët e vegjël.